



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E LIPJANIT  
REPUBLIC OF KOSOVO  
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Pranuar me: Primitjeto: 12.02.2024		
Mjesia Jednica	Numri B-roj	Shtojca Dodatak
15-052/01	8462	



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

NR:	
PËR:	Daut Azemin, Kryesues i Kuvendit
NGA:	Skender Bikliqi, kryesues i Komitetit për Komunitete <i>Zbrullosi</i>
DATË	12.02.2024
LËNDA:	Raporti i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023

I nderuar.  
Kryesues i Kuvendit, z. Daut Azemi.

Përmes kësaj shkrese po ua dërgoj, Raportin e Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023

Shtojcë: Raporti

## RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2023

Bazuar në nenin 53 pika 5.2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndermirren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Komfor këtij neni Komiteti për Komunitete nga fillimi i punës së tij është përkushtuar që të zbatojë mandatin e tij në përpikëri me qëllim të avancimit të të drejtave të barabarta për të gjithë qytetarët e komunës së Lipjanit.

Gjatë vitit që lamë pas, Komiteti për Komunitete ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, të kryesuara nga Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, në të cilat kanë marrë pjesë anëtarët e Komitetit:

1. Skender Bikliqi, Kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, Anëtare
3. Lumturije Bytyqi-Hasani, Anëtare
4. Shahadije Bikilqi Dragaçina, Anëtare
5. Enver Kryeziu, Anëtar
6. Idajet Garip, Anëtar
7. Slavisa Trajkovic, Anëtar
8. Zoran Cirkovic, Anëtar
9. Ana Guciq, Anëtare

Përgjatë mbledhjeve të këtij komiteti, anëtarët e saj çdoherë përveç pikave të përcaktuara kanë diskutuar edhe tema, probleme, e kërkesa, të komuniteteve nga lokalitete të ndryshme që janë adresuar nga anëtarët përfaqësues të komuniteteve, duke dhënë kontributin e tyre duke u munduar që ti trajtojnë ato që më pas të kishte rezultate konkrete në zgjidhjen e atyre problemeve dhe të kishte rezultate konkrete.

Ankesat apo kërkesat të cilat janë adresuar në këtë komitet kryesisht kishin të bënin me:

- Përmirësimin e gjendjes në infrastrukturë (ujësjellësi, ndërtimi i rrugë dhe rrugicave ,instalimi i rrjetit të kanalizimit, ndriçimi publik, pastrimi i varrezave etj...)
- Raport për mbarëvajtjen mësimin në shkollat ku mësojnë komunitetet

- Braktisja e shkollimit të nxënësve nga radhët e komuniteteve e në veçanti të atij rom dhe ashkali
- Mos vaksinimi i fëmijëve të komuniteteve kryesisht të atyre rom, ashkalinjë
- Mungesa e raporteve për shkollat ku mësojnë komuniteti serb
- Lehtësimi i kritereve, stimulimi më i madh apo dhënia përparësi për përfitim nga ndarja e subvencioneve në bujqësi

Komiteti për Komunitete ka mbajtur edhe disa vizita në teren duke i vizituar komunitetet jo shumicë që banojnë në Gadime, Magure, Medvec Rubovc Grackë dhe në Janjevë ku gjatë vizitës, si anëtarë të komitetit, kemi identifikuar probleme dhe kemi marrë kërkesa të ndryshme të qytetarëve.

Anëtarët e komitetit në çdo herë në Komitetin për Komunitete janë njoftuar nga përfaqësuesit e Zyrës Lokale për Komunitete të Komunës lidhur me punën dhe aktivitetet mujore të kësaj zyre, po ashtu edhe nga nënkryetari i komunës për ndonjë investim apo projekt që do të përfitojnë komunitetet jo shumicë

Krahas ndihmës solide për rastet e familjeve të komuniteteve që jetojnë në Komunën e Lipjanit për nevojat e ndryshme që kanë kërkuar mbështetje me aq mjete sa kanë pasur në dispozicion kjo zyrë ka shprehur si të pamjaftueshëm shumën e përcaktuar që aktualisht është e ndarë për këto kategori.

Prandaj pas diskutimit lidhur me këtë çështje anëtarët kanë qenë të pajtimit që buxheti ose shuma e mjeteve që duhet të ndahet për familjet nga radhët e komuniteteve që kanë nevojë për ndihmë të rritet pasi sipas përfaqësuesve të kësaj zyre ka vite që shuma është e njëjtë dhe asnjëherë nuk ka ndryshuar. Megjithëse sipas kësaj zyre, ka qenë zyra e kryetarit që në raste të caktuara ka ndarë mjete për aq sa i lejohet.

Komiteti në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar edhe nga ekzekutivi i Komunës që të marr pjesë në mbledhjet e rregullta të Komitetit siç ishte rasti me përfaqësues të drejtorisë së Bujqësisë, Shërbime publike, Infrastrukturës Lokale, Shëndetësisë, Arsimit, Buxhet e Financa etj. Por ka pasur edhe rast kur një nodnjë drejtori nuk i është përgjigjur ftesën për raportim.

Po ashtu edhe Nënkryetari për komunitete, z Lulzim Qerimi ka marrë pjesë po thuaj në të gjitha takimet. Në njërin nga mbledhjet e Komitetit ka marrë pjesë edhe përfaqësuesi i stacionit policor të Lipjanit, ku na ka njoftuar për gjendjen e sigurisë në territorin e komunës së Lipjanit.

Komiteti po ashtu është i hapur edhe për përfaqësuesit të OSBE-së, KFOR-it, UNMIK-ut dhe përfaqësues të tjerë të cilët monitorojnë punën e këtij Komiteti por edhe ofrojnë këshilla drejt përmirësimit të kushteve dhe shërbimeve për komunitetin jo shumicë.

Anëtarët e Komitetit vazhdimisht ngrisin çështjet që dalin nga puna në Komitet tek Kuvendi Komunal.

Po ashtu një falënderim te veçante e kemi edhe për Kryesuesin e Kuvendit Daut Azemin dhe Sektorin e Kuvendit të cilët çdo herë kanë qenë shumë bashkëpunues dhe te gatshëm që ta na përkrahin si komitetit si ne aspektin organizativ ashtu edhe ne atë teknik duke qenë çdo herë afër neve.

Komiteti do të vazhdojë të jetë afër me problemet e komunitetit jo shumicë, të ngrisë këto çështje tek organet përkatëse dhe ku ka nevojë të sensibilizojë opinionin.

Rekomandimet dhe shqetësimet të dalura nga puna e Komiteti jo gjithherë gjejnë vend në praktikë nga ana e ekzekutivit, prandaj ky Komitet do të angazhohet maksimalisht që këto çështje të trajtohen denjësisht nga organet kompetente komunale.

Anëtarët e komitetit në mbledhjen e fundit për vitin 2023 kanë hartuar edhe Planin e Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024 përmes së cilit përveç mbledhjeve të rregullta, ka paraparë të realizojë edhe vizita në fshatrat të banuara me komunitet jo shumicë dhe pas vizitave bazuar në gjendjen apo problemet me të cilat ballafaqohen komunitet të dalin me rekomandime për Kuvendin Komunal me qëllim të përmirësimit të jetës së tyre.

Me respekt!

Kryesuesi i Komitetit  
Skender Bikliqi

*Skender Bikliqi*